

# Mbledhja e kryesisë së shoqatës 17shkurti.ch

PROTOKOLL

DATA: 11.06.2017

KOHA: 10:30

VENDI: ZOLLIKON

<b>THIRRUR NGA:</b>	Kryetari Muhamet Guda
<b>NUMRI I MBLEDHJËS</b>	4
<b>UDHËHEQËS I MBLEDHJËS</b>	Muhamet Guda
<b>PROTOKOLLIN E SHKRUAN</b>	Visar Kryeziu
<b>PJESËMARRËS</b>	Faik Mahmuti, Muhamet Guda, Agron Zahiri, Visar Kryeziu
<b>MUNGOJNË</b>	Avni Kastrati (Gjendet ne Kosove)

## TEMAT E DITËS

1. Mirembajtesi i fshatit

DISKUTIMI	1. Mirembajtesi i fshatit	
<p>Me kerkese te Muhamet Gudes, u mbajt nje mbledhje e veçant e kryesise se shoqates ku pike diskutimi ishte doreheqja nga puna si mirembajtes i fshatit Bujar Zeqiri, me arsyetimin e tij se nuk mund te vazhdoj me pune shkak i problemit te tij shendetesor.</p> <p>Diskutohet se duhet te gjendet nje zgjidhje per mirembajtes te fshatit pasi qe nuk ka interesim te madh per kete pune dhe gjate konkurseve qe shpall shoqata gjithnje lajmerohen shume pak persona per kete pune!</p> <p>Muhameti thote se ka mjaftuar nga ana jone qe kemi perzgjedhur Agron Murselin pergjegjes per mirembajtesin dhe se ndoshta ka qene e tepert qe ne si krysi te kerkojme nga puntori qe te na dergojne fotografi çdo dite per punen qe ka bere ai gjate dites! Ai mendon poashtu se paga nuk eshte e ulet per mirembajtesin dhe nuk mundet me qene kjo arsye.</p> <p>Diskutohet qe pune ka me shume veres se sa dimrit dhe ndoshta kete vere ta kalojme me ndonje aksion apo te marrim puntor ditor ku do tju paguhet dita e punes.</p> <p>Agron Zahiri thote qe ne duhet bejeme publike qe puntori e ka lene punen dhe te shpallim nje konkurs e te jete i hapur deri me 15 Korrik. Zahiri mendon poashtu se pergjegjesi per mirembajtesit Agron murselit ti themi ne si kryesi qe te gjej ai vete puntor dhe tia paguajm ditën qe maksimalja te jete Fr 12.50.- dita dhe nese kjo shume llogaritet del e barabarte sikurse rroga e mirembajtesit qe kemi paguar deri me tash per çdo muaj. Kjo te jete oferta e vetme e shoqates qe mundet ta ofroj.</p> <p>Faiki mendon qe kjo pune nuk eshte vetem nje dite por ne duhet te gjejme zgjidhje per nje kohe me te gjate.</p> <p>Visari thote qe mos te ngutemi te shpallim konkurs por te provojme se si po funksionon keshtu me dite dhe nese eshte e suksesshme te vazhdojme keshtu e nese jo, ateher konkursin mundemi ta shpallim kur te dojm.</p>		
VENDIMI		
<p>Per nje kohe te mos shpallet konkursi per puntor, por u mor vendim qe Agron Murseli ta merr pergjegjesine qe te gjej puntor ditor qe te mirembahet fshati.</p> <p>Per nje dite pune mirembajtesi ditor te paguhet Fr. 12.50.- dita.</p>		
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI
<p>Visari te shkruaj njoftimin qe mirembajtesi ka lon punen. Agron Murseli te gjej puntor ditor</p>	<p>Visar Kryeziu &amp; Agron Murseli</p>	<p>Menjehere</p>